



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

V E N D I M

Nr. 469, Datë 31.07.2024

PËR

KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT FITUES PËR NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, VITI AKADEMIK 2023 – 2024, PROFILI NDIHMËS LIGJOR, Z. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, më datë 31.07.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar, për ndihmës ligjor, në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatit z. {...}”, relatuar nga znj. Gentiana Muçaj, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin dhe lejimin e kandidatës për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor;

V Ë R E N:

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Z. {...} është kandidat për në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili ndihmës ligjor dhe është vlerësuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bazë të vendimit nr. 157, datë 04.04.2023, se i plotëson kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimi në Programin Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2023 – 2024, profili “ndihmës ligjor”, sipas nenit 34, pika 6, nenit 53, pika 4, dhe nenit 55, të ligjit nr. 98/2016, “Për organiznjimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si ligji “Për Pushtetin Gjyqësor”) si dhe në kreun V, të Vendimit nr. 424, datë 12.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor” (referuar në vijim si vendimi 424/2020).

2. Kandidati ka marrë pjesë në provimin e organizuar dhe është përfshirë nga Shkolla e Magjistraturës, në listën e renditjes së kandidatëve fitues në Programin e Formimit Fillestar për ndihmës ligjor, viti akademik 2023 – 2024.

3. Në funksion të verifikimit në kohë të pasurisë dhe figurës, duke qenë se kjo procedurë është e ndërvarur nga raportimet dhe informacionet e subjekteve publike dhe private që, sipas ligjit, duhet t'i dërgohen Këshillit, sipas Vendimit nr. 473, datë 07.09.2023, u vendos fillimi i procedurës së verifikimit të kandidatëve për në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, profili ndihmës ligjor për vitin akademik 2023-2024, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat. Në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës, për kandidatin si ndihmës ligjor z. {...}, si relatore u caktua znj. Fatmira Luli.

4. Në datën 07.09.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 424/2020, kandidati z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës; - për caktimin e relatores së kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatores së caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

5. Brenda afatit treditör, kandidati depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare¹, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatoren e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Në datën 12.09.2023, bazuar në pikat 65 dhe 66, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 424/2020, kandidati z. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët fitues për në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, profili ndihmës ligjor për vitin akademik 2023-2024.

¹ Depozituar në Këshill me nr. 4662 prot., datë 11.09.2023.

7. Në datë 20.09.2023, u njoftua Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI), për listën e kandidatëve për në programin e formimit fillestar, për të cilët do të kryhej deklarimi i pasurisë².

8. Brenda afatit treditore, kandidati depozitoi në zyrën përkatëse të Këshillit formularët dhe autorizimet përkatëse³ dhe brenda datës 29.09.2023, kishte detyrimin për të dorëzuar të plotësuar formularin e deklarimit të pasurisë, pranë ILDKPKI-së,

9. Gjatë procedurës së verifikimit, nga data 07.09.2023, bazuar në pikën 67/b, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 424/2020, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët fitues për në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, profili ndihmës ligjor për vitin akademik 2023-2024, ndër ta edhe për z. {...}.

9.1 Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

10. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/b dhe 149, pika 5 e Kushtetutës së Republikës, në nenin 276, pika 7 e Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit nr. 5, datë 20.12.2018 “Mbi caktimin me short të mandatit 3-vjeçar të anëtarëve gjyqtarë dhe anëtarëve jogjyqtarë”, të ndryshuar, si dhe në vendimin e nr. 68, datë 25.07.2024 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me vendimin nr. 362 datë 29.07.2024, ka vendosur :

1. *Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Fatmira Luli.*
2. *Përfundimi i qëndrimit në detyrë të znj. Fatmira Luli më datë 26.07.2024.*

10.1 Në Mbledhjen Plenare të datës 31.07.2024 për shkak të mbarimit të mandatit të relatores së çështjes znj. Fatmira Luli, kjo çështje u relatua nga anëtarja e Komisionit të Planifikimit, Administrimit dhe Buxhetit znj. Gentiana Muçaj.

² Shkresa nr. 4853, datë 20.09.2023 drejtuar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

³ Depozituar në Këshill, me nr. 4784 prot., datë 15.09.2023.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT

A. Për verifikimin e pasurisë

11. Për kandidatin z. {...} u verifikua kriteri i pasurisë, sipas procedurës së përcaktuar në Seksionin B, të kreut VI, të vendimit 424/2020. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor raportin “*Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe të Interesave Privatë të kandidatit për institucionet e sistemit të drejtësisë {...}, për pranimin në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës/Ndihmës Ligjor*”, me nr. 194/24 prot., datë 23.02.2024⁴.

11.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidati {...} dhe personat e lidhur znj. {...} {...} (bashkëshortja) dhe znj. {...} {...} (nëna) kanë plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

11.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti, nga ILDKPKI janë kryer kontrole të plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidati {...} dhe personat e lidhur, duke konkluduar se për kandidatin:

- a) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

12. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...} dhe personat e lidhur znj. {...} {...} (bashkëshortja) dhe znj. {...} {...} (mamaja) u kërkua informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve⁵ dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave⁶.

12.1 Sipas informacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr.63872/1 prot., datë 05.10.2023, kandidati {...}, sipas të dhënave të sistemit informatik tatimor, rezultoi i regjistruar në organin tatimor me aktivitet privat. Kurse personat e lidhur me të, znj. {...} {...} (bashkëshortja) dhe znj. {...} {...} (mamaja), nuk rezultojnë të regjistruar në

⁴ Depozituar në Këshill, me nr. 4853/5 prot., datë 26.02.2024.

⁵ Shkresa nr. 4852 prot., datë 20.09.2023 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

⁶ Shkresa nr. 4851 prot., datë 20.09.2023 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

organin tatimor me aktivitete private. Me shkresën nr. 3185/1 prot., datë 05.10.2023, kandidati {...}, sipas të dhënave të sistemit informatik tatimor, rezultoi si administrator i subjektit “{...}” me Nipt K56618008, me status ligjor “PF, Person Fizik” datë 18.04.2005 dhe objekt i aktivitetit “ Avokat” .

12.2 Sipas informacionit të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr. 15593/1 prot., datë 05.10.2023, për kandidatin {...} dhe personat e lidhur znj. {...} {...} (bashkëshortja) dhe znj. {...} {...} (nëna), nga verifikimet në sistemin elektronik të administrimit të të dhënave të këtij organi, për periudhën Mars 2004 deri në 20.09.2023, nuk rezultoi ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

13. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, u vlerësua se nuk kishte vend për t’i kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë për z. {...}. Po ashtu, referuar të dhënave të përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, të nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja, si dhe ai i administruar nga korrespondenca me subjekte shtetërorë dhe privatë, dokumentacion që evidentohet hollësisht në Raport, sikundër dhe analizës financiare të bërë nga ky organ publik, përgjegjës për kontrollin e deklaramit të pasurive dhe konfliktit të interesave sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “*Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik*”, i ndryshuar, nuk u konstatua mangësi në raportim, shkak për të cilin u vlerësua se nuk kishte vend për raportim shtesë nga ky organ.

14. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat Këshilli konkludoi se nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit të tij. Konkretisht, rezultoi se:

- a) kandidati dhe personi i lidhur kanë plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidati dhe personi i lidhur kanë plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidati dhe personi i lidhur kanë burime financiare për të justifikuar pasuritë e tyre;
- d) deklarimi nga kandidati dhe personi i lidhur, i pasurisë, asetëve ose interesave private, të detyrueshme për t’u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë referuar “*Deklaratës së pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë*”.

B. Për kriterin e figurës

15. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i figurës, sipas procedurës së përcaktuar në Seksionin C, të Kreut VI të vendimit 424/2020. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese.

16. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe u verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit {...}, me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

17. Në kuadër të verifikimit të kriterit të figurës për kandidatin {...}, atij iu kërkua dhe u depozitua rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 15.09.2023, formulari i vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, si dhe autorizimi për Këshillin që, në zbatim të pikës 82, të Seksionit C, të Kreut VI, të vendimit 424/2020, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të saj në lidhje me figurën dhe integritetin. Në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, nga ana e Strukturës së Posaçme për Regjistrimin, Administrimin dhe Përpunimin e Formularëve të Vetëdeklarimit pranë KLGJ-së, janë kryer verifikimet e thelluara të të dhënave të formularit të vetëdeklarimit për gjendjen gjyqësore dhe gjendjen civile të kandidates. Në vijim të përgjigjeve të shkresave të ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme, nga Sektori i Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme⁷, nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi u kryhen verifikimet e rastit, nuk u konstatuan mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidati në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të ligjit, duke konkluduar se z. {...}: *“- ka dorëzuar formularin e vetdeklarimit më datë 15.09.2023; - formulari i vetdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të ëeb të KLGJ-së; - në formularin e vetdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji; - nuk ka deklaruar gjeneralitete të mëparshme; - nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore, rezultoi e padënuar nga gjykatat penale shqiptare; - nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes civile, nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile; - deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme”*. Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

⁷ Shkresa nr. 4847 prot., datë 20.09.2023 e Strukturës së Posaçme për Regjistrimin, Administrimin dhe Përpunimin e Formularëve të Vetëdeklarimit.

18. Mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor⁸, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës në të gjitha prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, duke përcjellë në Këshill, me shkresën (me nr. 1455/14 prot., datë 16.11.2023) e rregjistruar pranë nesh me nr. 4855/1 prot., datë 16.11.2023, përgjigjet zyrtare të 13 (trembëdhjetë) prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore të juridiksionit të përgjithshëm. Referuar përmbajtjes së përgjigjeve të ardhura nga 11 prokurori, rezulton se nga verifikimet e kryera, nuk rezultoi që kandidati {...} të ketë marrë cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal, ndaj tij të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal, ndaj tij të jetë zbatuar ndonjë masë me karakter personal ose pasuror, ose të ketë të dhëna për procedime penale të mos filluara, të pushuara dhe të pezulluara. Ndërsa, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka ardhur informacioni si më poshtë vijon, duke i bashkëlidhur dhe vendimet përkatëse :

- Me shkresën nr. 12133/1, datë 10.11.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, është përcjellë informacioni se shtetasi {...} :

- nuk është marrë asnjëherë në cilësinë e personit nën hetim
- nuk janë zbatuar ndaj tij ndonjë masë sigurimi me karakter personal ose pasuror
- ka patur një kallëzim të dërguar për kompetencë nga ish-Prokuroria e Krimeve të Rënda, ku përmendet emri i {...}t, mbi bazën e të cilit është rregjistruar procedimi nr. 460/2019, për veprat penale të parashikuara nga nenet 248 dhe 186 të Kodit Penal, procedim i cili nuk ka patur emër të regjistruar dhe është dërguar me kërkesë për pushim në gjykatë dhe kërkesa është miratuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë me vendimin nr. 402, datë 22.06.2022, por theksohet se ky vendim akoma nuk ka marrë formë të prerë.

- Me shkresën nr. 8245/1, datë 26.12.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, është përcjellë informacioni se për shtetasin {...}, i datëlindjes 01.09.1978, lindur në Shkodër, rezultojnë të regjistruara procedimet penale si më poshtë:

- Procedimi penal nr. 766/2018, i regjistruar për veprën penale të parashikuara nga neni 248 i Kodit Penal, i dërguar për gjykim me të pandehurin shtetasin {...};
- Kallëzimi penal nr. 607/2021, i referuar në lidhje me kallëzimin e bërë nga shtetasi Ded Preka ndaj shtetasit {...}, etj... për të cilin është marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal, më datë 10.06.2021.

⁸ Shkresa nr. 4855 prot., datë 20.09.2023 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

- Procedimi penal nr. 158/2013, i regjistruar mbi bazën e kallëzimit të shtetasit Merxhan Qerimaj ndaj shtetasit {...}, etj. Në lidhje me këtë procedim penal është marrë vendim për pushimin e procedimit penal, më datë 28.03.2013.
- Procedimi penal nr. 789/2020, i regjistruar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit Ded Preka ndaj shtetasit {...}, etj... për të cilin është bërë kërkesë në gjykatë për pushimin e procedimit penal.

19. Nga përgjigja e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me shkresën nr. 12136/1 prot, datë 03.10.2023⁹, nuk rezulton që kandidati të ketë marrë cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal, ndaj tij të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal, ndaj tij të jetë zbatuar ndonjë masë me karakter personal ose pasuror, ose të ketë të dhëna për procedime penale të mos filluara, të pushuara dhe të pezulluara.

20. Mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas shkresës me nr. 4859 prot, datë 20.09.2023, të gjitha gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm dhe ato të veçanta që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, kanë kryer verifikimet përkatëse duke përcjellë në Këshill, informacionin e kërkuar. Referuar përmbajtjes së 14 (katërbëdhjetë) përgjigjeve zyrtare të gjykatave, lidhur me verifikimet e kryera, nuk rezultoi që kandidati {...} të jetë marrë në cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal, ndaj tij të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal apo të jetë zbatuar ndonjë masë me karakter personal ose pasuror, ose të ketë të dhëna për procedime penale të mosfilluara, të pushuara dhe të pezulluara. Ndërsa, nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe nga Gjykata e Lartë ka ardhur informacioni i përshkruar si më poshtë, duke i bashkëlidhur dhe vendimet përkatëse :

- Me shkresën nr. 1469/1, datë 25.09.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, është përcjellë informacioni se për shtetasin {...} rezultojnë vendimet si më poshtë vijon:

- Vendimi nr. 1290 (3459), datë 12.07.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt *“Dërgimin në gjyq të çështjes penale me nr. 766, të vitit 2018”*.
- Vendimi nr. 1893 (5282), datë 10.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt *“Pushimin e procedimit penal nr. 789, viti 2020 për veprën penale “Shpërdorim detyre”* .

⁹ Kthyer në bazë të shkresës/kërkesë për informacion me nr. 4858 prot., datë 20.09.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

- Vendimi nr. 586 (5571), datë 01.12.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt *“Kundërshtimi i vendimit të Prokurorisë për “Mosfillimin e procedimit penal për nr. 670/2021, datë 10.06.2021”*.

- Me shkresën nr. 12635/1, datë 04.10.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Pëgjithshëm, është përcjellë informacioni se nga verifikimi i sistemit ICMIS rezultojnë të gjykuara 5 (pesë) çështje penale si më poshtë:

- Vendimi nr. 232, datë 20.08.2018, i Gjykatës së Apelit Shkodër, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. 1290 (3459), datë 12.07.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
- Vendimi nr. 43, datë 27.02.2014, i Gjykatës së Apelit Shkodër, i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. 93, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
- Vendimi nr. 147, datë 28.05.2021, i Gjykatës së Apelit Shkodër, i cili ka ndryshuar vendimin nr. 1893 (5282), datë 10.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke vendosur pranimin e kërkesë së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe duke pushuar procedimin penal nr. 789, viti 2020 për veprën penale *“Shpërdorim detyre”*.
- Vendimi nr. 86, datë 14.04.2022, i Gjykatës së Apelit Shkodër, i cili ka ndryshuar vendimin nr. 586 (5571), datë 01.12.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke vendosur pranimin e kërkesë së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe lënien në fuqi të vendimit për *“Mosfillimin e procedimit penal për kallëzim të rremë para oficerit të Policisë Gjyqësore”*.

- Me shkresën nr. 4671/1, datë 27.09.2023, të Gjykatës së Lartë, është përcjellë informacioni se nga verifikimi në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore rezulton se më datë 10.09.2021 është regjistruar çështja me nr. 70007-00622-00-2021 rregjistri, me kallëzues Ded Preka, person nën hetim {...}, etj., me objekt *“Pushim procedimi penal nr. 789, viti 2020, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”*. Aktualisht kjo çështje është në fazën e studimit dhe akoma nuk ka vendimmarrje nga Kolegji Penal.

20.1 Për sa më sipër, referuar dokumentacionit të administruar, nuk rezultojnë të dhëna se për kandidatin {...} ka elementë të cënimit të figurës, në kushtet kur organet kompetente kanë vlerësuar se në faktet objekt kallzimi nuk ka elementë të ndonjë vepre penale.

21. Mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor¹⁰, Byroja Kombëtare e Hetimit, me shkresën nr. 968/1 prot., datë 04.10.2023, nuk rezultuan të dhëna rreth figurës së kandidatit {...}.

¹⁰ Shkresa nr. 4850 prot., datë 20.09.2023 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

22. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {...}, janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat Këshilli konkludoi se nuk ekziston asnjë prej shkaqeve të skualifikimit të tij. Konkretisht, rezultoi se:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetë deklarimit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkuara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 83, Seksioni C, Kreu VI të vendimit 424/2020, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;
- c) për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- d) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë, bashkëpunëtorë, informatorë ose agjente e shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidatin nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me sjelljen etike dhe morale të tij, mbi të cilën të ngrihen dyshime për cenim të besimit publik në sistemin gjyqësor dhe, për rrjedhojë, mbi pranueshmërinë e tij për në formimin fillestar për ndihmës ligjor në Shkollën e Magjistraturës.

III. KONKLUSIONE

23. Referuar përcaktimeve të Vendimit 424/2020, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin fitues për ndihmës ligjor, z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

24. Bazuar në sa është parashtruar më lart mbi rezultatet e verifikimit të pasurisë e figurës, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati përmbush këto kritere dhe nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidatit fituese dhe lejimin e tij për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 53, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; në nenin 61, pika 1, 86 shkronja “ë” dhe 97 pika 1, shkronja “a” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, Këshilli i Lartë Gjyqësor

V E N D O S I:

1. Kualifikimin e kandidatit fitues z. {...} dhe lejimin e tij për ndjekjen e Programit të Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor.
2. Një kopje e vendimit të arsyetuar t’i njoftohet kandidatit, z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR